

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCAVE-MINISTARSTVO FINANSIJA-MINISTRY OF FINANCE
KESHILLI I KOSOVES PER RAPORTIM FINANCIAR
KOSOVSKE SA VET ZA FINANCISKO IZVESTAVANJE KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL

Mjese Org. DRP Nr. Prot. 708/2020
Org. Ju. Unit. Prot. No:
Nr. i faqevave Datum 27.04.2020
Drol shifra Date:
No. pages:

PRISHTINE/ PRISTINA / PRISHTINA

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR
RRONI FER SH.P.K.

31 DHJETOR 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raport i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
Pasqyra e rrjedhës së parash	8
Shënimet për pasqyrat financiare	9

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e Rroni Fer Sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Rroni Fer Sh.p.k. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekulitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar me këtë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë politikat materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë më 31 Dhjetor 2025, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion


Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Auditimin (ISA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabel të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabel (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin "IESBA". Ne besojmë se provat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për mendimin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, ishin më të rëndësishme në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u trajtuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë për to, dhe ne nuk japim një opinion të veçantë për këto çështje.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM KOSOVO SH.P.K which is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.



Çështja kryesore e auditimit	Si u trajtua çështja në auditimin tonë
Rreziku i mashtrimit në njohjen e të ardhurave ISA-të supozojnë se ekziston rreziku i mashtrimit në njohjen e të ardhurave në çdo angazhim auditimi. Ne u fokusuam në njohjen e të ardhurave sepse ekziston rreziku i mbivlerësimit të qëllimshëm të të ardhurave nga menaxhmenti për të përmbushur objektivin e shitjeve dhe për të siguruar stimuj të performancës. Përveç kësaj, ekziston rreziku që Kompania mund të mos ketë regjistruar siç duhet transaksionet e të ardhurave në lidhje me kthimet e shitjeve në fund të vitit. Politikat përkatëse të kontabilitetit, gjykimet dhe vlerësimet janë shpalosur në shënimet 2.3 dhe 15 në pasqyrat financiare. I	Procedurat tona të auditimit përfshinin, por nuk u kufizuan në aktivitetet e mëposhtme: - Vlerësimi i politikave kontabël të Kompanisë mbi njohjen e të ardhurave nga perspektiva e standardeve SNRF. - Ne testuam dizajnin dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve mbi sistemet e të ardhurave, për të përcaktuar shtrirjen e testimeve thelbësore shtesë të kërkuara. - Ne kontrolluam që të ardhurat ishin njohur në perludhën e duhur duke testuar një mostër transaksionesh dhe duke krahasuar datat e fletdërgsave kundrejt të cilave ishin njohur të ardhurat. - Ne testuam në bazë të mostrës që transaksionet e të ardhurave në lidhje me kthimet e shitjeve në fund të vitit dhe pas fundvitit njihen siç duhet. - Performuam teste të tjera thelbësore të detajeve dhe procedurave analitike. - Ne kemi vlerësuar përshtatshmërinë e shpalosjeve të kompanisë në lidhje me të ardhurat.
Ekzistenca dhe vlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera Të arkëtueshmet tregtare njihen në vlerën e tyre të parashikuar të realizueshme, e cila është shuma origjinale e faturuar minus provizionimin e vlerësuar të dëmtimit. Provizionimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta përcaktohen bazuar në vlerësimin e menaxhmentit të humbjeve të pritshme të kredisë, duke marrë parasysh vjetërsinë e balancave, ekzistencën e mosmarrëveshjeve, modelet e fundit historike të pagesave dhe çdo informacion tjetër të disponueshëm në lidhje me aftësinë kreditore të palëve. Menaxhmenti përdor këtë informacion për të përcaktuar nëse kërkohet një provizion për dëmtim ose për një transaksion specifik ose për bilancin e një klienti në përgjithësi. Ne i referohemi pasqyrave financiare, shënimet 7 të arkëtueshme tregtare të tjera dhe shënimet 24.1	Procedurat tona të auditimit përfshinin si vijon: - Ne vlerësuam procedurat e kontrollit kreditor të Kompanisë dhe vlerësuam dhe vërtetuam profilin e vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera. - Ne vlerësuam rikuperueshmërinë në bazë të mostrës duke lu referuar parave të marra pas fundvitit, marrëveshjes me kushtet e kontratës në fuqi dhe lëshimit të notave kreditore pas fundvitit. - Ne kemi marrë në bazë të mostrës konfirmimet nga palët e treta dhe kemi rakorduar diferencat. - Ne kemi konsideruar përshtatshmërinë e gjykrimeve në lidhje me provizionimet për të arkëtueshmet tregtare dhe kemi vlerësuar nëse këto provizionime janë llogaritur në përputhje me modelin e humbjeve të pritshme të llogarive të arkëtueshme. - Ne kemi konsideruar plotësinë dhe saktësinë e shpalosjeve.

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përfshijnë raportin e menaxhmentit dhe pasqyrën e qeverisjes korporative por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit. Ne kemi pranuar informatat tjera para datës së raportit të auditorit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informatat tjera dhe, përveç se në masën e shprehur në mënyrë të qartë në raportin tonë, ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose përndryshe duket të jenë materialisht të keq deklaruara.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative kemi marr parasysh nëse përfshin shpalosjet e kërkuara nga Neni 7 i Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditim.

Bazuar, vetëm në punën që kërkohet të bëhet gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme sipas opinionit tonë:

- Informacioni i shpalosur në raportin e menaxhmentit për vitin financiar për të cilin përgatiten pasqyrat financiare, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale me informacionin në pasqyrat financiare dhe përgatitet në përputhje me kërkesat e nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, dhe
- deklarata e qeverisjes së korporatave është përgatitur në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin.

Për më tepër, bazuar në njohuritë dhe kuptimin e entitetit dhe mjedisit në të cilin operon, të pranuar gjatë auditimit, neve na kërkohet të raportojmë nëse kemi identifikuar ndonjë keqdeklarim material të fakteve në informata tjera. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë aspekt.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për një kontroll të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë për të vazhduar si vijimësi, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që lidhen me vijimësinë dhe duke përdorur bazën e vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur menaxhmenti ka ndërmend të likuidojë Kompaninë ose të të pushojë operacionet, ose nuk ka alternativë realiste përveç sa më sipër.

Përsoneat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport auditori që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale kur ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.



Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me ISA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, interpretime të deforuara ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin në mënyrë që të hartohen procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Të konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit nga menaxhmenti dhe, bazuar në provat e auditimit të marra, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Kompanisë për të vazhduar si një biznes i vazhdueshëm. Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë për zbulimet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto zbulime janë të papërshtatshme, të modifikojmë mendimin tonë. Konkluzionet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditorit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që Kompania të pushojë së vazhduar si një biznes i vazhdueshëm.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu u ofrojmë atyre të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë se kemi respektuar kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë dhe komunikojmë me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që mund të mendohen në mënyrë të arsyeshme se kanë të bëjnë me pavarësinë tonë, dhe kur është e aplikueshme, masat mbrojtëse të lidhura.

Nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për rrjedhojë janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Rroni Fer Sh.p.k. na emëroi më 24 Shtator 2025 i auditorë të Shoqërisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025. Ky është viti ynë i shtatë si auditues të Kompanisë nga hyrja në fuqi i ligjit Nr. 06/L-032.

Ne konfirmojmë se:

- Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese të përmendura në nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr. 02/2019 dhe kemi qenë të pavarur nga Kompania në kryerjen e auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Republika e Kosovës

10 Prill 2026

Faqe | 4

V. Hamiti

Valbona Hamiti

Auditor Ligjor






Deklaratë e Pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2025

Bazuar në njohuritë tona më të mira deklaroj që pasqyrat financiare të Rroni Fer sh.p.k për vitin raportues që përfundon më 31 dhjetor 2025 përveq qështjeve të përshkruara në opinionin e auditimit, praqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtim me të gjitha kërkesat e Ligjit 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.



Z. Gent Laçi
Drejtor Gjeneral



Znj. Albana Skiviani
Drejtor Financiar

30 Marsi 2026

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
NË 31 DHJETOR 2025

	Shënimet	2025 EUR '000	2024 EUR '000
PASURITË			
PASURITË AFATGJATA			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	17,690	16,692
Pasuritë e paprekshme	5	63	1
		17,753	16,693
PASURITË AFATSHKURTA			
Inventarët	6	13,777	10,051
Të arkëlueshmet tregtare dhe të tjera	7	16,002	9,385
Paraja dhe ekuivalentët e parashë	8	2,376	1,637
		32,155	21,073
GJITHSEJ PASURITË		49,908	37,666
EKUITETI DHE DETYRIMET			
EKUITETI			
Kapitali Aksionarëve	9	76	76
Rezerva e rivelesimit		1,793	1,793
Filtimet e mbajtura		14,558	11,520
GJITHSEJ EKUITETI		16,427	13,389
DETYRIMET			
DETYRIMET AFATGJATA			
Huazimet që barin interes	10	8,526	6,423
Të hyrat e shtyera nga grantet	11	320	371
Detyrimet e qirasë	13	291	-
		9,136	6,794
DETYRIMET AFATSHKURTA			
Huazimet që barin interes	10	12,610	10,709
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	12	7,898	4,573
Detyrimet e qirasë	13	73	63
Detyrimet kontraktuale	14	3,756	1,856
Tatimi mbi të ardhurat i pagueshem		8	282
		24,345	17,483
GJITHSEJ DETYRIMET		33,481	24,277
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		49,908	37,666

Këto pasqyrë financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 30 Mars 2026 dhe janë nënshkruar në emër të saj nga:

Z. Gent Lajçi
Drejtor Gjeneral

Znj. Albana Sklyjari
Drejtor Financiar

Z. Taulant Vokshi
Kontablistë e certifikuar

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Shënime	2025 EUR '000	2024 EUR '000
Shitjet	15	101,973	80,636
Kostoja e mallrave të shitura	16	(93,168)	(71,299)
FITIMI BRUTO		8,805	9,337
Të hyra tjera operative	17	310	75
Shpenzimet administrative dhe të përgjithshme	18	(3,195)	(2,679)
Kostot e shpërndarjes		(387)	(268)
Shpenzime të tjera		(27)	(31)
Provizionimi i të arkëtueshmeve	7	(123)	(379)
Humbje/fitim nga këmbimi valutor, neto		(452)	65
FITIMI NGA OPERACIONET		4,931	6,120
Shpenzimet financiare, neto	19	(1,205)	(965)
FITIMI PARA TATIMIT		3,726	5,155
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	20	(384)	(583)
FITIMI PËR VITIN		3,342	4,572
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN		3,342	4,572

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Kapitali i aksionarit EUR '000	Rezerva e Rivlerësimit EUR '000	Fitimet e mbajtura EUR '000	Gjithsej EUR '000
MË 01 JANAR 2025	76	1,793	11,520	13,389
<u>Transaksionet me pronarët</u>				
Dividenta (Shënimi 9)	-	-	(304)	(304)
Gjithsej transaksionet me pronarët	-	-	(304)	(304)
Fitimi për vitin	-	-	3,342	3,342
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT GJITHËPËRFSHIRËSE	-	-	3,342	3,342
MË 31 DHJETOR 2025	76	1,793	14,558	16,427
 NË 01 JANAR 2024	 76	 1,793	 7,654	 9,523
<u>Transaksionet me pronarët</u>				
Dividenta (Shënimi 9)	-	-	(706)	(706)
Gjithsej transaksionet me pronarët	-	-	(706)	(706)
Fitimi për vitin	-	-	4,572	4,572
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
GJITHSEJ HUMBJA GJITHËPËRFSHIRËSE	-	-	4,572	4,572
MË 31 DHJETOR 2024	76	1,793	11,520	13,389

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

	Shënimet	2025 EUR'000	2024 EUR '000
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi para tatimit		3,726	5,155
<i>E korrigjuar për:</i>			
Zhvlerësim dhe amortizim	4,5	1,629	1,388
Shpenzimet e interesit		1,205	965
Lirimi i grantit në fitim (humbje)		(51)	(54)
Provizionimi i të arkëtueshmeve		123	379
Humbje nga çnjohja e kontratave të qirasë		5	-
Humbja nga shitja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		(19)	(11)
Fitimi nga operacionet para ndryshimeve në kapitalin punues		6,617	7,822
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>			
Inventarët		(3,726)	(4,549)
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(6,740)	129
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera dhe detyrimet e kontratës		5,206	(2,274)
Fitimi nga operacionet pas ndryshimeve të kapitalit qarkullues		1,358	1,128
Interesi i paguar		(1,205)	(965)
Tatimi mbi të ardhurat i paguar		(658)	(321)
Paraja neto e gjeneruar/(përdorur në) nga aktivitetet operative		(505)	(158)
AKTIVITETET INVESTUESE			
(Blerja) e pronës, impianteve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(2,646)	(3,004)
Të ardhurat nga shitja e automjeteve dhe pajisjeve		271	63
Paraja neto (e përdorur në) aktivitetet investuese		(2,375)	(2,941)
AKTIVITETET FINANCIARE			
Pagesa e dividendit	9	(288)	(645)
Të hyrat nga Grantet		-	4
Marrja e huazimeve		4,003	4,169
Pagesat e qirasë		(96)	(32)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		3,619	3,496
NDRYSHIMET NETO NË PARA DHE EKVIVALENTET E PARASË		739	397
Paraja dhe ekvivalentët e parasë në fillim		1,637	1,240
PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË NË FUND	8	2,376	1,637

SHËNIME (VIJON)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

SHËNIME

	Faqe
1 Informacion i përgjithshëm	10
2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	10
3 Gjykime të rëndësishme dhe burimet kryesore të vlerësimit të pasigurisë	20
4 Prona, implantet dhe pajisjet	21
5 Pasuritë e paprekshme	22
6 Inventarët	23
7 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	23
8 Paraja dhe ekuivalentet e parasë	24
9 Ekulteti	24
10 Huazimet	25
11 Grante Qeveritare	26
12 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	26
13 Detyrimet e qirasë	26
14 Detyrimet kontraktuale	27
15 Të hyrat	27
16 Kosto e mallit të shitur	27
17 Të hyrat tjera operative	27
18 Shpenzimet e shitjes, administrative dhe të tjera	28
19 Shpenzimet financiare	28
20 Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	29
21 Instrumentet Financiare sipas kategorisë	30
22 Matjet e Vlerës së Drejtë	30
23 Informacion mbi rreziket financiare	31
24 Menaxhimi i riskut së kapitalit	33
25 Transaksionet me palë të ndërlidhura	34
26 Zotimet dhe kontigjencat	35
27 Ngjarjet pas perludhës raportuese	35

SHËNIME (VIJON)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

SHËNIME
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Rroni Fer Sh.p.k. ("Kompania") është Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar Inkorporuar dhe e vendosur në Gjakovë, Republika e Kosovës. Kompania është themeluar gjatë shkurtit 2007. Adresa e zyrës së regjistruar qendrore të saj është: R. Martin Camaj, 26/A, Gjakovë, Republika e Kosovës.

Aktivitetet kryesore të biznesit të kompanisë janë prodhimi i rrjetave të çelikut, shufrave të çelikut dhe produkteve të tjera të hekurit dhe çelikut që përdoren në ndërtim. Kompania operon në tregjet lokale dhe rajonale dhe deri më 31 dhjetor 2025 punëson 184 punonjës (2024: 156 punonjës).

POLITIKAT MATERIALE TE KONTABILITETIT

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë.

BAZA E PËRGATITJES DHE DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi një bazë vijimësie dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), këto standarde dhe interpretime të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF për secilin lloj të pasurive, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë të përshkruara më gjerësisht në politikat kontabël më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël kritike. Gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose zonat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në Shënimin 3: Gjykim i rëndësishëm dhe burimet kryesore të vlerësimit të pasigurisë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur që nga dhe për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2025 dhe 2024. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyrë financiare shprehen në mijëra euro, përveç nëse thuhet ndryshe. Sipas nevojës, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

2.2 STANDARDET E REJA APO TË NDRYSHUARA KONTABËL DHE INTERPRETIMET E MIRATUARA

Kompania ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimit nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme të reja janë në fuqi për periudhën vjetore që fillon më 1 janar 2025:

- Mungesa e këmbueshmërisë (Ndryshime në IAS 21)

STANDARDET, NDRYSHIMET DHE INTERPRETIMET NË STANDARDET EKZISTUESE QË NUK JANË EFEKTIVE OSE NUK JANË MIRATUAR MË HERËT

IFRS 18, së bashku me ndryshimet në standardet e tjera, hyn në fuqi për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2027. Zbatimi i hershëm lejohet, por duhet të shpaloset. IFRS 18 do të zbatohet në mënyrë retrospektive. Shoqëria aktualisht është duke punuar për të identifikuar të gjitha ndikimet që këto ndryshime do të kenë në pasqyrat kryesore financiare dhe në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Standardet dhe ndryshimet e tjera që ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe që nuk janë zbatuar herët nga Shoqëria përfshijnë:

- Ndryshime në klasifikimin dhe matjen e Instrumenteve financiare (Ndryshime në IFRS 9 dhe IFRS 7)
- Kontrata që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra (Ndryshime në IFRS 9 dhe IFRS 7)

SHËNIME (VIJON)
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

- Përmirësime vjetore të Standardeve të Kontabilitetit IFRS – Vëllimi 11
- IFRS 19 "Shoqëritë bijë pa përgjegjësi publike: Shpalosjet"
- Ndryshime në IFRS 19 "Shoqëritë bijë pa përgjegjësi publike: Shpalosjet"

Këto standarde, ndryshime dhe interpretime nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhat aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e ardhshme të parashikueshme.

SHËNIME (VIJON) PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

2.3 NJOHJA E TË ARDHURAVE

Kompania l'njeh të ardhurat si më poshtë:

Të hyrat nga kontratat me klient

E hyra njihet në shumën që reflekton vlerësimin për të cilën kompania pritët të jetë e thirrur në shkëmbimin e të mirave apo shërbimeve të klientit. Për çdo kontratë me klient, kompania: identifikon kontratën me klientin; identifikon obligimet në kontratë; përcakton çmimin e transaksionit që merr në llogari vlerësimet e ndryshme dhe vlerën në kohë të parasë; alokon çmimin e transaksionit për detyrimet e veçanta në bazë të çmimit të shitjes së pavarur të çdo malli apo shërbimi që do të dërgohet; dhe njeh të hyrat kur ose secili obligim është përfunduar në një mënyrë që përshkruan transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara.

Vlerësimet e ndryshme brenda çmimit të transaksionit, nëse ka, reflektojnë koncesionet të siguruara të klientit siç janë zbritjet, rabatet dhe rimbursimet, çdo bonus potencial i arkëtueshëm nga klienti dhe çdo ngjarje tjetër kontingjente. Vlerësimet e tilla përcaktohen duke përdorur ose metodën e 'vlerës së pritur' ose metodën e 'vlerës më të mundshme për të ndodhur'. Matja e vlerësimeve të ndryshme i nënshtrohet një parimi kufizues prej ku shitja do të njihet vetëm deri në shkallën që është shumë e mundshme që një kthim domethënës në vlerën e grumbulluar të shitjes nuk do të ndodhë. Vlerësimi i kufizuar vazhdon derisa pasiguria e shoqëruar me vlerësimin e ndryshëm zgjidhet më pas. Shumat e pranuar që i nënshtrohen parimit të kufizuar njihen fillimisht si të hyra të shtyra në formë të një detyrimi të ndarë rimbursues.

Shitja e mallrave

E hyra nga shitja njihet në momentin kur klienti përfiton kontroll mbi të mirat, që në përgjithësi është në kohën e dërgesës

Dhënia e shërbimeve

E hyra nga një kontratë për të siguruar shërbime njihet sipas kohës kur shërbimet kryhen duke u bazuar ose në një çmim fikse ose në bazë të një tarife për orë.

Interesi

E hyra nga interesi është njohur kur interesi ndodh duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo është një metodë e kalkulimit të kostos së amortizuar së një pasurie financiare dhe e alokimit të hyrave të interesit nëpër periudhën relevante duke përdorur normën e interesit efektiv, normë e cila saktësisht zbret pranimet e parasë së gatshme të parashikuar përmes pritshmërisë së pasurisë financiare për vlerën neto kontabël të pasurisë financiare.

Qiraja

E hyra nga qiraja nga investimet në prona njihet sipas bazës drejtvizore në periudhën e qirasë. Qiraja e nxitur e dhuruar njihet si pjesë e të hyrave të qirasë. Qiratë kontingjente njihen si e hyrë në periudhën kur fitohen.

Të ardhura të tjera

Të ardhurat tjera njihen kur pagesa pranohet apo kur e drejta për të pranuar pagesën është krijuar.

1.4 SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pas shfrytëzimit të shërbimit ose në datën e ndodhjes së tij.

SHËNIME (VIJON) PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

2.5 KLASIFIKIMI AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË

Pasuritë dhe detyrimet janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në klasifikimin afatshkurtër dhe atë afatgjatë.

Një pasuri klasifikohet si afatshkurtër kur: ose pritet të realizohet ose të synojë të shitet ose të konsumohet në ciklin normal të punës të kompanisë; ai mbahet kryesisht për qëllime të tregtimit; pritet të realizohet brenda 12 muajve pas perludhës raportuese; ose pasuria është para një ose ekuivalent i parësë së gatshme, përveç nëse nuk është i kufizuar nga shkëmbimi ose përdorimi për të shlyer detyrimin për të paktën 12 muaj pas perludhës raportuese. Të gjitha pasuritë e tjera klasifikohen si afatgjata.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur: ose pritet të shlyhet në ciklin normal të punës të kompanisë; ai mbahet kryesisht për qëllime të tregtimit; ajo duhet të zgjidhet brenda 12 muajve pas perludhës raportuese; ose nuk ka asnjë të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas perludhës raportuese. Të gjitha detyrimet e tjera klasifikohen si afatgjata.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra klasifikohen gjithnjë si afatgjata.

2.6 GRANTET QEVERTARE

Grantet e qeverisë nuk njihen deri sa të ekzistojë një bazë e arsyeshme e sigurisë që Kompania do të përmbushë kushtet që u kërkojnë atyre dhe se grantet do të pranohen.

Grantet qeveritare të cilat kanë kusht parësor që Kompania të blejë, të ndërtojë ose të blejë pasuri afatgjata, njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar dhe transferohen në fitim ose humbje në baza sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të pasurisë.

Grantet e tjera qeveritare njihen si të ardhura gjatë perludhave të nevojshme për t'u përputhur me kostot për të cilat ato synojnë të kompensojnë, në baza sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet e bëra tashmë ose për qëllim të dhënies së mbështetjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa shpenzime të ardhshme, njihen në fitimin ose humbjen në perludhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

2.7 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

Pronat, impiantet dhe pajisjet që ekzistojnë më 31 Dhjetor 2013, mbahen me vlerën më të vogël se zhvlerësimi i akumuluar. Shumat e rivlerësuar janë përcaktuar në bazë të vlerësimit të kryer më 31 Dhjetor 2013 nga vlerësues të pavarur profesional. Rezultati i vlerësimit, i llogaritur si diferencë midis vlerës kontabël neto të pasurive të kontabillizuara në datën e vlerësimit dhe shumës së rivlerësuar, është marrë në llogarinë e rezervës së rivlerësimit që është pjesë e kapitalit të aksionarëve.

Blerjet e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktiveve ose njihen si një aktiv i veçantë, respektivisht, vetëm kur ekziston një probabilitet i hyrjes së ardhshme të përfitimeve ekonomike të Kompanisë që lidhen me artikullin, dhe kur vlera e kostos së zërave mund të matet në mënyrë të arsyeshme. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen, njihen në pasqyrën e të ardhurave kompresive si të ndodhura.

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve të tjera tarifohet në bazë lineare përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurive. Jetët e dobishme të vlerësuar janë si më poshtë:

Ndërtesat	20 vjet
Linjat e prodhimit	10 vjet
Automjete dhe pajisje të tjera	10 dhe 5 vjet

SHËNIME (VIJON) PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

Vlerat e mbetura, jetëgjatësia e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen dhe, nëse është e përshtatshme, rregullohen në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë midis vlerës kontabël dhe të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit njihen në fitim ose humbje.

2.8 PASURITË E PAPREKSHME

Pasuritë e paprekshme të Kompanisë përbëhen nga softueri. Në njohjen fillestare, pasuritë jo-materiale të blera veçmas maten me kosto. Kostoja e një pasurie jo-materiale të blerë veçmas përfshin çmimin e blerjes, duke përfshirë detyrimet e importit dhe taksat e pakthyeshme të blerjes, pas heqjes së rabateve dhe zbritjeve tregtare dhe çdo kosto drejtpërdrejt të atribueshme për përgatitjen e pasurisë për përdorimin e saj të synuar.

Pas njohjes fillestare, pasuritë jo-materiale mbarten me kosto minus prej çdo amortizimi të akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Amortizimi njihet në bazë të linjës së drejtë gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Metoda e vlerësuar e jetës së dobishme dhe e amortizimit rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese me efektin e çdo ndryshimi në vlerësimin që llogaritet në një bazë të ardhshme. Jetët e dobishme të aplikuar janë si më poshtë:

Softuer 5 vjet

Një pasuri e paprekshme çregjistrohet në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose nxjerrja jashtë përdorimit. Fitimet ose humbjet që vijnë nga mosnjohja e një pasurie të paprekshme – matur si diferencë midis të ardhurave neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të pasurisë – njihen në fitim ose humbje kur pasuria çregjistrohet.

2.9 PASURIA ME TË DREJTË TË PËRDORIMIT

Një pasuri me të drejtë të përdorimit njihet në datën e fillimit të qirasë. Pasuritë me të drejtë të përdorimit maten me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë, të rregulluar, siç është e aplikueshme, për çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit të cfarëdo stimulimi të qirase neto, çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar, dhe, përveç kur përfshihen në koston e inventarëve, një vlerësim i kostove që pritet të bëhen për çmontimin dhe heqjen e pasurisë themelore, dhe rivendosjen e pozicionit ose pasurisë.

Pasuritë me të drejtë të përdorimit zhvlerësohen në metodë lineare për periudhën e pashlyer të qirasë ose jetëgjatësisë së vlefshme të pasurisë, cilado që është më e shkurtër. Kur njësia ekonomike e konsoliduar pret që të marrë pronësinë mbi pasurinë e dhënë me qira në fund të afatit të qirasë, zhvlerësimi është mbi jetën e tij të dobishme të vlerësuar. Pasuritë me të drejtë të përdorimit i nënshtrohen zhvlerësimit ose rregullohen për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë.

Kompania ka zgjedhur të mos njohë një pasuri me të drejtë të përdorimit dhe detyrimin korrespondues të qirasë për qira afatshkurtër me kushte 12 muaj ose më pak dhe qira të pasurive me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë në këto pasuri shpenzohen në fitim ose humbje siç ndodhin.

2.10 ZHVLERËSIMI I PASURIVE JOFINANCIARE

Dëmtimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve dhe aktiveve jo-materiale me jetë të kufizuar të dobishme

Vlera bartëse e këtyre pasurive ndryshon në çdo datë raportimi për shumën e zhvlerësimit dhe kur një pasuri është zhvlerësuar, njihet shpenzim përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes në shumën e vlerësuar të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë në përdorim dhe vlera e drejt minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurisë individuale ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare. Shuma e rikuperueshme përcaktohet për një pasuri individuale, përveç nëse pasuria nuk gjeneron rrjedha monetare të cilat janë kryesisht të pavarura nga ato të pasurive ose grupeve të tjera të pasurive. Në këtë rast, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i takon pasuria.

Vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar të pasurisë/artikujve. Vlerat aktuale janë përlogaritur duke përdorur normat e skontimit para tatimit që pasqyrojnë vlerën kohore të pasasë dhe rreziqet specifike të pasurisë/njësisë, zhvlerësimi i së cilave është duke u matur.

SHËNIME (VIJON) PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

Humbjet nga zhvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare alokohen së pari kundrejt emrit të mirë të njësisë dhe më pas pro rata në mesin e pasurive të tjera të njësisë. Rritjet e mëpasshme të shumës së rikuperueshme, shkaktuar nga ndryshimet në vlerësime janë kredituar në fitim ose humbje në atë masë që ato të kthejnë zhvlerësimin.

2.11 INVENTARËT

Inventarët mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar në koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes gjatë aktivitetit normal të biznesit, pas llogaritjes së të gjitha shpenzimeve të mëtejshme të kompletimit dhe shitjes. Kostoja përcaktohet në bazë të metodës së mesatares së ponderuar. Kostoja e produkteve të gatshme dhe e punës në progres përbëhet nga lëndët e para, puna direkte, kostot e tjera të drejtpërdrejta dhe shpenzimet e ndërldhura të prodhimit.

Shlyerja është bërë për njësitë e vjetërsuara dhe të nxjerra nga përdorimi, bazuar në përdorimin e pritshëm të tyre në të ardhmen dhe vlerës neto të realizueshme.

2.12 INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja dhe mosnjohja

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar. Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur al shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm finandmi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korigjuar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme).

Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Pasuritë financiare me kosto të amortizuar.
- Pasuritë financiare me vlera të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL).
- Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si FVOCI dhe (FVTPL).

Klasifikimi përcaktohet nga të dyja:

- Modeli i biznesit së njësisë ekonomike në menaxhimin e pasurisë financiare.
- Karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare të cilat njihen në fitim ose humbje janë përfshirë brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare, të cilat paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja pasuese e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me kosto të amortizuar atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të përcaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër një modeli biznesor, qëllimi i së cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe grumbullimi i flukseve monetare kontraktuale.
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare sjellin flukse monetare që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

SHËNIME (VUJON) PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e Interesit efektiv. Zbritja hiqet aty ku efekti i skontimit është jomaterial. Paraja dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera të kompanisë hyjnë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare përbrenda një modeli biznesor të ndryshëm nga ai i "mbajtur për të grumbulluar" ose i "mbajtur për të grumbulluar dhe shitur" kategorizohen tek pasuritë me vlerë të drejtë, përmes fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli biznesor i pasurive financiare, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit, llogariten në FVTPL. Të gjitha Instrumentet financiare derivative përfshihen në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, ndaj të cilave aplikohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës. Matja e pasurive të kësaj kategorie bëhet me vlerë të drejtë me fitim ose humbje tek fitimi ose humbja. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke luajtur referuar transaksioneve të tregut aktiv ose përmes një teknike vlerësimi të cilat nuk e njohin ekzistencën e tregut aktiv.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë aktiv financiar të kategorizuar si (FVTPL).

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Grupi llogaritet për aktivet financiare në FVOCI nëse asetet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, objektivi i të cilit është "mbajtja për të grumbulluar" e flukseve monetare shoqëruese dhe shitja si dhe
- kushtet kontraktuale të këtyre pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit të shumës kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) do riklasifikohet pas mosnjohjes së pasurisë.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka pasuri financiare të kategorizuara si (FVOCI).

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 vënë më tepër në përdorim informacionet e së ardhshmes me qëllim të njohjes së humbjeve të pritura të kreditit - 'modelin e humbjes së prituri të kreditit (HPK)'. Kjo e zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjes së ndodhur'. Instrumentet brenda kuadrit të fushëveprimit të kërkesave të reja ka përfshirë kreditë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me kosto të amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e kontratës të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për lëshuesin) nuk maten me vlerë të drejtë nëpërmes fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk është më e varur nga Kompania, e cila edhe fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes së kredisë. Në vend të kësaj, Kompania merr në konsideratë një gamë më të gjerë informacionesh, me rastin e vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritura të kreditit, përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet e tanishme, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që kanë ndikim në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të së ardhmes, dallimi midis tyre bëhet si vijon:

- instrumentet financiare që nuk kanë pësuar përqekësim të dukshëm të cilësisë së kredisë nisur që nga njohja fillestare, ose ato me rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që cilësinë e kredisë e kanë përqekësuar dukshëm që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë të së cilave është jo i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' mbulon pasuritë financiare të cilat posedojnë dëshmi objektive të zhvlerësimit të tyre, në datën e raportimit. 'Humbjet e pritura 12 - mujore të kredisë' njihen në kategorinë e parë, ndërsa 'jetëgjatësia e humbjeve të pritura të kreditit' në kategorinë e dytë. Matja e humbjeve të pritura të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

SHËNIME (VIJON) PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Kompania vë në përdorim një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera të saj, dhe regjistron kompensimin për humbjet si jetëgjatësia e humbjeve të pritura të kredisë. Këto janë mangësitë e pritura tek flukset e mjeteve monetare kontraktuale, marrë në konsideratë potencialin e mosplotësisht në çdo moment përgjatë ciklit jetësor të instrumentit financiar. Kompania përdor përvojën e saj historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e së ardhmes për llogaritjen e humbjeve të pritura të kredisë duke përdorur matricën e provizionit. Kompania vlerëson zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare të saj në baza kolektive, meqë ato kanë karakteristika të përbashkëta të rrezikut të kredisë, të cilat janë të grupuara në bazën e ditëve të kaluara. Referojuni Shënimit të Rrezikut të Kredisë për një analizë të detajuar të asaj se si aplikohen kërkesat e zhvlerësimit të SNRF 9.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë të pagueshmet tregtare dhe të tjera në datat e raportimit.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, rregullohen për kostot e transaksionit, përveç rastit kur Kompania ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me përjashtim të derivativëve dhe detyrimeve financiare të përcaktuara me FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative që janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha tarifat e lidhura me interesin dhe, nëse zbatohet, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

2.13 PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë, depozitat në të parë dhe investime të tjera afatshkurta tejet-likuide të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur parash të gatshme dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë.

2.14 TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe më pas maten me koston të amortizuar përmes metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë. Të arkëtueshmet tregtare në përgjithësi kanë afatin e shlyerjes brenda 30 ditësh.

Për matjen e humbjeve të pritur të kredisë, Kompania ka zbatuar qasjen e thjeshtuar, e cila bën kompensimin e humbjeve të pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së saj. Për të matur humbjet e pritura të kredisë, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të ditëve të vonuara.

Të arkëtueshmet e tjera njihen me koston të amortizuar, duke zbritur çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë.

2.5 DETYRIMET E QIRASË

